



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.45

21 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.191, datë 22.3.2007	Për vendosjen e oponentëve teknikë shtetërorë për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, me koncesion	1147
Udhëzim i KM nr.2, datë 4.4.2007	Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “K”, për vitin 2007	1151
Vendim i ERE nr.21, datë 4.4.2007	Për miratimin e rregullores së procedurave të licencimit	1155
Vendim i ERE nr.22, datë 11.4.2007	Për mosfillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga H/C “Egnatia”, komuna Hotolisht, Librazhd, të “Remi” sh.p.k.....	1166
Vendim i ERE nr.23, datë 11.4.2007	Për mosfillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës për transferim të licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga “Dardania Energji” sh.p.k. tek “EN-KU” sh.p.k.....	1166
Vendim i ERE nr.24, datë 11.4.2007	Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion.....	1167
Vendim i ERE nr.25, datë 11.4.2007	Për përcaktimin, për vitin 2007, të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion	1169
	Shpallje kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preket nga rehabilitimi i rrugës së Zall-Herrit.....	1170

Shpallje kërkesë për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, e cila preket nga realizimi i projektit të furnizimit me ujë nga rezervuari i Manskurisë në Golem.....	1170
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Rahmi Como.....	1171

VENDIM
Nr.191, datë 22.3.2007

**PËR VENDOSJEN E Oponencës Teknike Shtetërore për Projektet e
Ndërtimit të Hidrocentraleve, me Koncesion**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të gjitha projektet e propozuara për ndërtimin e hidrocentraleve, me koncesion, nga personat privatë, fizikë apo juridikë, të huaj apo vendas, të bëhet oponenta teknike shtetërore.

2. Oponenta teknike shtetërore për projektet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhet nga një grup ekspertësh të shquar në fushën e inxhinierisë, hidroteknike e gjeologjike, ekonomistë dhe juristë. Ky grup nuk do të jetë më shumë se 16 ekspertë. Emërimi i tyre dhe mënyra e funksionimit të këtij grupi bëhen me udhëzim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Grupi i ekspertëve do të bëjë vlerësimin e projekteve për shfrytëzimin optimal të burimeve ujore, si dhe do të kryejë kontrollin teknik të projekteve, sipas kërkesave të parashikuara në ligjet nr.8093, datë 1.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, dhe nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

4. Grupi i ekspertëve, pas përfundimit të oponentës, harton raportin përkatës, i cili shqyrtohet dhe miratohet, me shumicë votash, nga këshilli drejtues i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Materiali i oponentës, së bashku me raportin e miratuar, është pjesë e dokumenteve, që i dërgohen Autoritetit Kontraktues, për vazhdimin e procedurave.

5. Grupi i ekspertëve të shpërblehet, si më poshtë vijon:

a) Kryetari 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj;

b) Anëtarët 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Grupit të ekspertëve t’i shtohet 10 për qind e vlerës totale të shpërblimit, për përballimin e shpenzimeve operative.

6. Grupi i ekspertëve për të gjithë periudhën e kryerjes së oponentës teknike lidh kontrata pune me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

7. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 15 950 000 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për të përballuar pagesat e grupit të ekspertëve deri në fund të vitit 2007.

8. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TERMAT E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS (TIP) TË PUNËS, PËR KRYERJEN E Oponencës teknike “PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË HEC-EVE, ME KONCESION”

Neni 1

Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e oponencës teknike “Për projektet e ndërtimit të HEC-eve, me koncesion” nga grupi i ekspertëve.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj kontrate jepen këto përkufizime:

3.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis grupit të ekspertëve dhe METE për kryerjen e oponencës teknike “Për projektet e ndërtimit të HEC-ve, me koncesion”.

3.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet grupit të ekspertëve në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.191, datë 22.3.2007 “Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të HEC-ve me koncesion”.

3.3 “Objekt i kontratës” do të thotë kryerja e oponencës teknike për projektin/projektet e ndërtimit të HEC-eve me koncesion.

3.4 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës që janë METE dhe grupi i ekspertëve, të miratuar me urdhër të Ministrit.

3.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë METE.

3.6 “Kontraktues” do të thotë grupi i eksperëve.

3.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga kontraktuesi sipas kontratës.

Neni 3

Hartimi i kontratës

4.1 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4

Praktikat korruptive dhe konflikti i interesit

5.1 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë subjekt që paraqet projektin për oponencë. Në rast të konstatimit, kontraktuesi detyrohet të vetëpërgjashtohet nga kjo oponencë.

5.2 Kontraktuesi lejon Autoritetin Kontraktues të inspektojë punën e kryer në zbatim të kontratës.

5.3 Autoriteti Kontraktues, në rast konstatimi të pikave të mësipërme, ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë ose përsëritjen e oponencës me ekspertë të tjerë.

Neni 5

Informacioni konfidencial

6.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me oponencën.

Neni 6

Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë shërbimet dhe të përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, efçente dhe ekonomike, në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji

të avancuar dhe të përshtatshme, si dhe metoda të sigurta.

7.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes së profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe të ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta, duke përfshirë median, dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Autoritetit Kontraktues.

7.5 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet siç specifikohet te kontrata.

7.6 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata, duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentet, studimet, skicimet dhe planimetritë.

7.7 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet, duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetet Kontraktuese dhe të marrë parasysh standardet më të fundit.

7.8 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet në zbatimin e shërbimeve siç kërkohet në kontratë dhe ia paraqet atë Autoritetit Kontraktues.

Neni 7 **Vendndodhja**

8.1 Puna do të kryhet në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

Neni 8 **Siguracioni i përgjegjësisë profesionale**

9.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale, sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin, për ta zhdëmtuar Autoritetin Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve.

9.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e shërbimeve që po sigurohen.

Neni 9 **Çmimi i kontratës**

10.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë shpërblimi i ofruar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____ datë _____ “Për projektet e ndërtimit të HEC-eve, me koncesion”.

Neni 10 **Afatet e pagesës**

11.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë, siç specifikohet në kontratë.

11.2 Me përjashtim kur parashkohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë shqiptare.

11.3 Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitoen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 11 **Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit**

12.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

12.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e shërbimeve brenda periudhës së kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japë kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

12.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakord për një zgjatje të afatit në rastin e forcës Madhore.

12.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë.

12.6 Të gjitha pikat e mësipërme përcaktohen me hollësi në kontratë.

Neni 12

Penalitete

13.1 Në kontratë palët do të parashikojnë konkretisht penalitetet për rastet e dorëzimit me vonesë të oponencave, si dhe moskryerjen e tyre për faj të kontraktuesit.

13.2 Masa e penalitetit dhe mënyra e pagesës së tij do të specifikohen në kontratë.

Neni 13

Negociatat dhe amendamentet

14.1 Palët kanë të drejtë të negociojnë, të bëjnë ndryshime ose amendamente për kushtet e kontratës.

14.2 Kushtet e negocimit dhe amendimit specifikohen në kontratë.

14.3 Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 14

Nënkontrata

15.1 Nuk lejohet lidhja e një nënkontrate nga kontraktuesi.

15.2 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës, me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 15

Baza ligjore

16.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

17.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17
Përfaqësimi i palëve

18.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura dhe ekzekutimin e kontratës.

18.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dëshiron të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

18.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e Autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 18
Lajmërimet

19.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

19.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 19
Llogaritja e afateve

20.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike, me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

UDHËZIM
Nr.2, datë 4.4.2007

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, DHE TË KOEFICIENTIT "K", PËR VITIN 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14 të ligjit nr.9416, datë 25.5.2005 "Për procedurat e privatizimit të banesave, të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore, nga Enti Kombëtar i Banesave", dhe të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2007, të jetë 29 874 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.
2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mestare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, për vitin 2007, sipas qyteteve, të jetë sipas tabelave nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.
3. Vlera e koeficientit "K" të jetë sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
4. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e kostos mesatare të ndërtimit, si dhe për zonat rurale, të merren vlerat e qytetit më të afërt, sipas tabelës.
5. Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t'iu referuar zonave të afërta.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KOSTOJA MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 2007

Në këtë vlerë të koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik,
2. projektit,
3. studimit gjeologjik dhe sizmik,
4. lejes së ndërtimit,
5. truallit,
6. shpenzimeve operacionale të EKB 4%.

Tabela 1

Nr.	Qyteti	Çmimi për njësi (mesatare aritmetike)	
		Sip.shfrytëzimi lekë/m ²	Sip.ndërtimi lekë/m ²
1	Berat	29 667	24 794
2	Dibër	31 141	26 029
3	Durrës	30 098	25 141
4	Elbasan	28 104	23 482
5	Ersekë	30 311	25 324
6	Fier	29 663	24 796
7	Gramsh	28 802	24 071
8	Gjirokastër	30 182	25 226
9	Korçë	30 301	25 317
10	Krujë	29 176	24 382
11	Kavajë	29 762	24 867
12	Kuçovë	29 457	24 618
13	Kukës	31 758	26 542
14	Laç	29 042	24 267
15	Lezhë	29 127	24 336
16	Librazhd	28 584	23 886
17	Lushnjë	30 543	25 526
18	Mat	30 297	25 317
19	Përrenjas	29 170	24 378
20	Peqin	29 099	24 317
21	Përmet	30 279	25 289
22	Pogradec	30 060	25 124
23	Pukë	30 391	25 398
24	Rrëshen	29 415	24 582
25	Skrapar	29 757	24 872
26	Sarandë	30 289	25 314
27	Shkodër	30 001	25 072
28	Tepelenë	29 961	25 040
29	Tropojë	31 986	26 734
30	Tiranë	29 914	24 993
31	Vlorë	29 743	24 844

	Kosto mesatare	29 874	24 964
--	----------------	--------	--------

Për qytetet të cilat nuk janë përfshirë në listë, të merret kostoja mesatare e qytetit më të afërt.
TË DHËNAT E TREGUT TË LIRË TË APARTAMENTEVE PËR VITIN 2007

Tabela nr.2

Nr.	Qytetet	Kostoja e shitjes lekë/m ² sip shfrytëzimi për tregun e lirë
1	Berat	30 451
2	Bulqizë	18 116
3	Cërrik	32 746
4	Çorovodë	9 835
5	Delvinë	23 750
6	Devoll	36 545
7	Dibër	31 940
8	Durrës	81 080
9	Elbasan	44 065
10	Fier	48 953
11	Fushë-Krujë	33 151
12	Fushë-Arrëz	7 932
13	Gjirokastër	45 876
14	Gramsh	31 031
15	Has	29 667
16	Himarë	50 174
17	Kavajë	43 102
18	Këlcyrë	14 915
19	Kolonjë	25 564
20	Korçë	47 201
21	Krujë	38 734
22	Kuçovë	23 392
23	Kukës	27 204
24	Laç	31 722
25	Leskovik	21 974
26	Lezhë	64 571
27	Librazhd	35 951
28	Lushnjë	40 529
29	M.Madhe	37 250
30	Maliq	30 913
31	Mallakastër	29 951
32	Mamurras	22 614
33	Mat	29 315
34	Memaliaj	8 763
35	Mirditë	31 180
36	Patos	18 680
37	Peqin	36 520
38	Përmet	23 191
39	Pogradec	46 222
40	Polican	9 877
41	Përrenjas	33 902
42	Pukë	13 128
43	Roskovec	29 336

44	Rubik	34 000
45	Sarandë	50 537
46	Shëngjin	68 482
47	Shkodër	47 509
48	Shijak	39 026
49	Tepelenë	16 851
50	Tiranë	97 000
51	Tropojë	22 861
52	Vau i Dejës	23 415
53	Vlorë	49 335
54	Vorë	55 348

VLEFTA E KOEFICIENTIT “K” PËR VITIN 2007

Tabela nr.3

Nr.	Qytetet	Vlera e koeficientit “K”
1	Berat	1.0264
2	Bulqizë	0.5818
3	Cërrik	1.1652
4	Çorovodë	0.3305
5	Delvinë	0.7841
6	Devoll	1.2061
7	Dibër	1.0256
8	Durrës	2.6939
9	Elbasan	1.5679
10	Fier	1.6503
11	Fushë-Krujë	1.1362
12	Fushë-Arrës	0.2547
13	Gjirokastër	1.5200
14	Gramsh	1.0774
15	Has	0.9342
16	Himarë	1.6869
17	Kavajë	1.4482
18	Këlcyrë	0.4926
19	Kolonjë	0.8434
20	Korçë	1.5577
21	Krujë	1.3276
22	Kuçovë	0.7941
23	Kukës	0.8566
24	Laç	1.0923
25	Leskovik	0.7257
26	Lezhë	2.2169
27	Librazhd	1.2577
28	Lushnjë	1.3270
29	M.Madhe	1.2416
30	Maliq	1.0202
31	Mallakastër	1.0097
32	Mamurras	0.7787
33	Mat	0.9676
34	Memaliaj	0.2925

35	Mirditë	1.0600
36	Patos	0.6297
37	Peqin	1.2550
38	Përmet	0.7659
39	Pogradec	1.5377
40	Poliçan	0.3329
41	Përrenjas	1.1622
42	Pukë	0.4320
43	Roskovec	0.9890
44	Rubik	1.1222
45	Sarandë	1.6685
46	Shëngjin	2.3512
47	Shkodër	1.5836
48	Shijak	1.2966
49	Tepelenë	0.5624
50	Tiranë	3.2426
51	Tropojë	0.7147
52	Vau i Dejës	0.7805
53	Vlorë	1.6587
54	Vorë	1.8503

VENDIM

Nr.21, datë 4.4.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË LICENCIMIT

Në mbështetje të neneve 9, pika 3, dhe 14 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 24 të rregullores për procedurat e licencimit, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.37, datë 9.7.2004, të ndryshuar; neneve 15 dhe 19 të rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale, të ndryshuar; Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2007, mbasi shqyrtoi draftin e rregullores së procedurave të licencimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së procedurave të licencimit (bashkëngjitur këtij vendimi).
2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.37, datë 9.7.2004 “Për miratimin e rregullores së procedurave të licencimit”, të ndryshuar.
3. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 14.10.2004 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 14 pika 2 dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat e licencimit për ushtrimin e aktiviteteve të parashikuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, duke specifikuar kriteret dhe kushtet për dhënien, ndryshimin, rinovimin e licencës, si dhe autoritetin e ERE-s për përcaktimin e pagesave që duhet kryer për çdo tip aplikimi për licencë.

Neni 3

Përkufizime

Në këto rregulla termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

1. “Aplikues” d.m.th. çdo person që aplikon për një licencë sipas kësaj rregulloreje.
2. “Aplikimi” d.m.th. kërkesa për licencim e shoqëruar me dokumentet të parashikuara në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje dhe për të cilin Bordi i Komisionerëve merr vendim për fillimin ose jo të procedurave të licencimit sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.
3. “Bordi i Komisionerëve” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
4. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, që vepron sipas ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
5. “Licencë” do të thotë autorizimi që i jepet një personi sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, për të operuar në sektorin e energjisë elektrike, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike, si dhe prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, eksportin dhe importin e energjisë elektrike.
6. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e energjisë elektrike.
7. “Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik.
8. “I deleguari përgjegjës” do të thotë një person fizik/juridik, që aplikon për një licencë në emër të një aplikuesi sipas nenit 7.
9. “Drejtuesit kryesorë” do të thotë administratori, drejtori i përgjithshëm ose menaxher i nivelit të lartë të personit, si dhe drejtuesit kryesorë inxhiniero-teknik të objektit.
10. “OST” do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit.
11. OSSH do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Neni 4

Licencat

1. ERE lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike;
 - b) transmetimin e energjisë elektrike;
 - c) shpërndarjen e energjisë elektrike;
 - d) furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike;
 - e) eksportimin e energjisë elektrike;
 - f) importimin e energjisë elektrike.
2. Nuk kërkohet licencë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një vetëprodhuesi të palidhur me sistemin elektroenergjetik dhe për ndërtimin e një linjë direkte.

Neni 5

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave të lëshuara nga ERE për veprimtaritë e parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, përcaktohet nga ERE brenda kufijve të mëposhtëm:
 - a) për prodhimin e energjisë elektrike, deri në 30 vjet;
 - b) për transmetimin e energjisë elektrike, deri në 25 vjet;
 - c) për shpërndarjen e energjisë elektrike, deri në 20 vjet;
 - d) për furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, deri në 5 vjet;
 - e) për eksportin e energjisë elektrike, deri në 3 vjet;
 - f) për importin e energjisë elektrike, deri në 3 vjet.

KAPITULLI II

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENCË

Neni 6

E drejta për të aplikuar për një licencë

Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERE, çdo person që ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri, dhe me objekt të veprimtarisë aktivitetin e kërkuar për licencim. Çdo person i huaj duhet të krijojë një shoqëri sipas legjislacionit në fuqi, me objekt veprimtaritë e licencuara nga ERE për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës.

Neni 7

Delegimi i të drejtave të aplikuesit

1. Aplikuesi mund të caktojë një person fizik ose juridik si të deleguar përgjegjës për të aplikuar për një licencë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këto procedura licencimi.
2. I deleguari përgjegjës do të paraqesë në ERE:
 - a) prokurën e aplikuesit për përfaqësimin e tij;
 - b) vërtetim që i deleguari përgjegjës nuk është përfshirë në një poçes të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).
3. Detyrat e të deleguarit përgjegjës janë:
 - a) të paraqesë aplikimin për një licencë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje;
 - b) të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë shqyrtimit të aplikimit për licencë.

Neni 8

Paraqitja e aplikimit për licencë

1. Çdo aplikim do të paraqitet në formën e përcaktuar sipas kësaj rregulloreje ose në të kundërt nuk do të shqyrtohet.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar. Vërtetimet dhe deklaratat nga organe e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

3. Çdo dokument duhet të paraqitet në gjuhën shqipe dhe nëse është i përkthyer, duhet të noterizohet.

4. Në rast mosplotësimi të një ose disa prej kërkesave të aplikimit, aplikuesi do të japë shpjegime me shkrim në lidhje me arsyet ose shkaqet e mosplotësimi të kërkesave. Shpjegimet e mësipërme i bashkëngjiten, sipas renditjes së përcaktuar në nenin 9, dokumentacionit të aplikimit.

5. Mosdhënia e shpjegimeve në lidhje me arsyet ose shkaqet e mosplotësimi do të konsiderohet si mosparaqitje e dokumentacionit në formën e përcaktuar nga rregullorja dhe aplikimi nuk do të merret në shqyrtim për fillimin e procedurave të licencimit.

Neni 9

Dokumentacioni për aplikim

1. Çdo aplikim për licencë, pavarësisht aktivitetit që kërkohet të licencohet, do të paraqitet sipas formatit të mëposhtëm, i cili duhet të përmbajë:

Formati i aplikimit Të dhëna të përgjithshme identifikuese	
Emri i aplikuesit	
Adresa e selisë qendrore	
Drejtuesi i personit	
I deleguari përgjegjës	
NIPT-i	
Telefon	
Cel	
Fax	
E-mail	
Nr. i llogarisë bankare (e veçantë për aktivitetin për të cilin kërkohet licenca)	
Tipi i licencës për të cilën aplikohet	

2. Dokumentacioni juridik që shoqëron kërkesën:

a) Akti i themelimit të personit;
b) Statuti i personit;
c) Vendimi i regjistrimit në regjistrin tregtar të gjykatës;
d) Vërtetim që personi dhe drejtuesit kryesorë të tij, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata);

e) Dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit mbi asetet që do të përdoren për kryerjen e aktivitetit të licencuar në vartësi të veprimtarisë që do të ushtrojë;

f) Një deklaratë të aplikuesit që tregon nëse aplikuesit i është refuzuar/hequr ose jo ndonjëherë një licencë për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin, importin ose eksportin e energjisë elektrike në ndonjë vend, dhe në rast se po, arsyet e refuzimit/heqjes.

3. Dokumentacioni në fushën financiare dhe fiskale:

a) Certifikatë e regjistrimit në organin tatimor;

b) Vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave;

c) Vërtetim për regjistrimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

d) Vërtetim për siguracion (apo një kontratë sigurimi me një nga agjencitë e sigurimit) të veprimtarisë së aplikuesit në sektorin e energjisë elektrike;

e) Vërtetim që personi nuk është në proces falimentimi;

f) Paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së tij;

g) Vërtetimin e pagimit në llogari të ERE-s, të pagesës së regjistrimit për marrje licence, sipas aneksit A të kësaj rregulloreje.

h) Dokument për mbështetjen financiare nga institucionet financiare.

4. Kërkesa në fushën administrative dhe organizative:

a) Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria;

b) Lidhjet dhe pjesëmarrjet ekzistuese në personat e tjerë. Paraqitja e veprimtarisë që kryen ky person;

c) Përshkrim i aktiviteteve të tjera që kryen aplikuesi jashtë fushës së energjisë elektrike;

d) Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrative të personit;

e) Aftësitë tekniko-organizative dhe profesionale të personelit drejtues (CV-të e tyre).

5. Të dhënat specifike sipas tipit të licencës

Në varësi të tipit të licencës, aplikuesit duhet të paraqesin në ERE dokumentet e mëposhtme:

1. Për ndërtimin dhe instalimin e një centrali të ri, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ky ose nga një central ekzistues

a) 1. Të dhëna specifike për HEC-in

Nr.	Emërtimi	Të dhënat
1	Emri i HEC-it	
2	Vendndodhja	
3	Tipi i HEC-it	
4	Viti i ndërtimit	
5	Data e fillimi të punimeve dhe data që mendohet për vënien në punë (vetëm për centralet e rinj dhe ata ekzistues që nuk janë në gjendje pune*)	
6	Jetëgjatësia e pritshme (vetëm për centralet e rinj*)	
7	Fuqia e instaluar S (KVA ose MVA)	
8	Tensioni V në dalje të gjeneratorit	
10	Tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhte centrali	
11	Numri i njësisve gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës	
12	Prurjet mesatare Q (l/s) ose m ³	
13	Kapaciteti ujëmbledhës i basenit W (m ³)	
14	Rënia H _{netto} (m)	
15	Prodhimi vjetor i energjisë E _{vjet} (kWh)	
16	Tipi i turbinës	
17	Rendimenti	

a) 2. Të dhëna specifike për nënstacionin

1	Emri i N/St , nivelet e tensionit (KV)	Të dhënat
2	Skema principiale e nënstacionit	
3	Transformatori, tipi, fuqia nominale (Sn), KVA ose MVA, tensioni i pëstjellave (TL, TM, TU – KV), tensioni i lidhjes së shkurtër Ulsh në %, Humbjet e fuqisë në boshllëk.	
4	Linja transmetuese (parametrat teknikë)	
5	Të dhëna teknike të pajisjeve primare të N/St	

b) Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik hartohet sikurse dokumentacioni i paraqitur për marrjen e

koncesionit dhe përmban:

1. Projektin, i cili përfshin:

- Studimin e fisibilitetit mbi zgjidhjen teknike më optimale;
- Preventivin përfundimtar të objektit;
- Grafikon e zbatimit të projektit;
- Karakteristikat teknike të makinerive dhe pajisjeve kryesore që do të instalohen;
- Studimin dhe projektin mbi mënyrën e lidhjes me sistemin;
- Oponencën tekniko-ekonomike të objektit nga ekspertë të licencuar.

c) Dokumente të tjera:

- Marrëveshje koncesioni ose dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit mbi asetet që do të përdoren për kryerjen e aktivitetit të licencuar për HEC-et e privatizuara;
- Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike;
- Lejet ose autorizimet mjedisore nga organet përkatëse në nivel lokal dhe kombëtar (vetëm për centralet e rinj*);
- Miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën dhe mënyrën e lidhjes në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes.

A. Të dhëna specifike për centralet me erë (eolike)

Nr.	Emërtimi	Të dhënat
1	Emri i centralit	
2	Vendndodhja	
3	Tipi i centralit	
4	Viti i ndërtimit	
5	Data e fillimit të punimeve dhe data që mendohet për vënien në punë (vetëm për centralet e rinj dhe ata ekzistues që nuk janë në gjendje pune*)	
6	Jetëgjatësia e pritshme (vetëm për centralet e rinj*)	
7	Fuqia e instaluar S (KVA ose MVA)	
8	Tensioni V në dalje të generatorit	
10	Tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhte centrali	
11	Numri i njësisve gjeneruese dhe fuqia e instaluar e secilës	
12	Shpejtësia e erës, minimale dhe maksimale e shfrytëzueshme	
13	Dimensionet kryesore (lartësia, diametri i elikës, tipi i kullës)	
14	Orët e punës në një vit	
15	Prodhimi vjetor i energjisë E_{vjet} (kWh)	
16	Rendimenti	

b) 1. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik përmban:

Projektin, i cili përfshin:

- Studimin e fisibilitetit mbi zgjidhjen teknike më optimale;
- Preventivin përfundimtar të objektit;
- Grafikon e zbatimit të projektit;
- Karakteristikat teknike të makinerive dhe pajisjeve kryesore që do të instalohen;
- Studimin dhe projektin mbi mënyrën e lidhjes me sistemin;
- Oponencën tekniko-ekonomike të objektit nga ekspertë të licencuar.

b) 2. Dokumente të tjera:

- Miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën edhe mënyrën e lidhjes në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes;
- Lejet ose autorizimet mjedisore nga organet përkatëse në nivel lokal dhe kombëtar;
- Dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit mbi asetet që do të përdoren për kryerjen e aktivitetit të licencuar;

C. Të dhëna specifike për TEC-in

1	Emri i TEC-it	Të dhënat
2	Vendndodhja	
3	Tipi i TEC-it	
4	Viti i ndërtimit	
5	Data e fillimit të punimeve dhe data e vënies në punë*	
6	Jetëgjatësia e pritshme*	
7	Fuqia e instaluar S (KVA)	
8	Numri i agregateve	
9	Tipi, numri dhe fuqia e turbinës	
10	Prodhimi vjetor i energjisë E _{vjet} (kWh)	
11	Prodhimi i avullit (ton/orë)	
12	Rendimenti energjetik	
13	Lloji i lëndës djegëse	
14	Konsumi vjetor i lëndës djegëse dhe konsumi vjetor i ujit	

c) 1. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik hartohet sikurse dokumentacioni i paraqitur për marrjen e koncesionit dhe përmban:

- Studimin e fisibilitetit mbi zgjidhjen teknike më optimale;
- Preventivin përfundimtar të objektit;
- Grafikon e zbatimit të projektit;
- Karakteristikat teknike të makinerive dhe pajisjeve kryesore që do të instalohen;
- Studimin dhe projektin mbi mënyrën e lidhjes me sistemin;
- Oponencën tekniko-ekonomike të objektit nga ekspertë të licencuar.

c) 2. Dokumente të tjera:

- Marrëveshje koncesioni;
- Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike;
- Lejet ose autorizimet mjedisore nga organet përkatëse në nivel lokal dhe kombëtar;
- Miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën edhe mënyrën e lidhjes në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes;

- Marrëveshjet paraprake për sigurinë e furnizimit me lëndë djegëse.

2. Për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike:

a) Skema elektrike principale e linjave të transmetimit dhe e nënstacioneve transformuese që administrohen nga OST-ja;

b) Lista e linjave të transmetimit (ajrore, kabllore), gjatësitë në km, parametrat teknikë të tyre, niveli i tensionit, kapaciteti nominal transmetues në MW dhe gjurma e linjës në hartën topografike;

c) Lista e pikave të marrjes-dhënies dhe matjes së energjisë elektrike ndërmjet sistemit të transmetimit dhe centraleve, rrjeteve të shpërndarjes dhe konsumatorëve të lidhur në rrjetin e transmetimit, tipi i matjes, vendndodhja e aparateve matëse;

d) Lista e linjave të interkonjeksionit, gjatësitë e tyre në km, parametrat teknikë të tyre, niveli i tensionit, kapaciteti nominal transmetues në MW dhe gjurma e linjës në hartën topografike;

e) Planet e investimeve për zgjerimin e sistemit të transmetimit;

f) Planet e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit.

g) Standardet teknike të linjave, elementeve përbërëse të tyre, transformatorëve, autotransformatorëve, pajisjeve kyçëse-çkyçëse dhe elementeve të tjera të nënstacioneve;

h) Sasia mesatare e energjisë elektrike e parashikuar për t'u transmetuar gjatë një viti në

GWh, e ndarë sipas muajve;

- i) Numri i konsumatorëve të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
3. Për veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike:
- a) Gjatësia totale e rrjetit shpërndarës në km (linja ajrore, kabllore, ajrore-kabllore) sipas niveleve të tensionit të punës së tyre;
 - b) Lista e linjave 35kV, 20kV, 10kV dhe 6kV parametrat teknikë të tyre;
 - c) Lista e nënstacioneve shpërndarëse 110/35/10kV, 110/35/6kV, 110/20kV, 35/6kV, fuqitë transformuese të instaluar në to;
 - d) Numri i kabinave të transformimit në nivelin TM/TU, ndarë sipas niveleve të tensionit;
 - e) Lista e pikave të marrjes së energjisë elektrike nga sistemi i transmetimit (niveli i tensioneve, si dhe mënyra e realizimit të matjes);
 - f) Lista e centraleve prodhuese të energjisë elektrike të lidhur direkt me rrjetin e shpërndarjes ose nëpërmjet një nënstacioni transformimi (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes);
 - g) Numri i konsumatorëve që furnizon me energji elektrike të ndarë sipas kategorive;
 - h) Sasia mesatare e energjisë së parashikuar për t'u shpërndarë gjatë një viti e paraqitur sipas një grafiku tip mujor;
 - i) Planet e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës;
 - j) Planet e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës;
4. Për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike.
- a) Sasia e energjisë mesatare të parashikuar për furnizimin e konsumatorëve gjatë një viti në

GWh;

- b) Numri i konsumatorëve të kualifikuar ose tariforë që do të furnizojë;
 - c) Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar;
 - d) Kapitali financiar për ushtrimin e aktivitetit.
5. Për aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike:
- a) Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u importuar ose eksportuar në GWh;
 - b) Kapitali financiar për ushtrimin e këtij aktiviteti;
 - c) Realizimi i kontratave të mëparshme, nëse ka pasur.

Neni 10

Shqyrtimi i aplikimit për licencë

1. Pasi shqyrton aplikimin e paraqitur lidhur me plotësimin e kërkesave të nenit 8 dhe 9, Drejtoria e Licencave dhe e Monitorimit dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe e Marrëdhënieve me Publikun përgatit një relacion ku i propozojnë Bordit të ERE-s fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë, në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullat e praktikës dhe procedurave.

2. Bordi i ERE-s mund të vendosë për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë, bazuar në relacionin e sipërpërmendur dhe do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit brenda 3 ditëve pune.

3. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

4. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri për të njëjtën licencë brenda tri muajve nga marrja e vendimit të Bordit për mosfillimin e procedurave, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

5. Në rast të miratimit të fillimit të procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë, ERE publikon në median e shkruar njoftimin për aplikimin për licencë brenda 3 ditëve.

6. ERE do të publikojë në median e shkruar për dy ditë me radhë në tri gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë:

- a) një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së aplikimit;
- b) një njoftim, që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të bëhen në ERE brenda dy muajve nga data e publikimit të parë.

7. Pas publikimit në media të njoftimit, për një periudhe 2-mujore nga data e parë e publikimit të njoftimit, ERE do të sigurojë që aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese apo çdo informacion tjetër janë të disponueshme për inspektimin e publikut në zyrat e saj.

8. Për centralet me kapacitet deri 5 MW, në përputhje me nenin 14 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, periudha e përcaktuar në pikën 7 do të jetë 1 muaj.

9. ERE, duke marrë parasysh pretendimet e aplikuesit, mund të vendosë se cilat informacione ose dokumente mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë inspektimin e tyre nga ana e palëve të interesuara.

Neni 11

Paraqitja e informacionit shtesë

1. Duke filluar nga data e publikimit të parë në media të njoftimit për aplikimin deri në përfundim të afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 5 dhe 6, ERE mund t’i kërkojë aplikuesit të paraqesë informacion shtesë, në formën dhe brenda një afati të caktuar, lidhur me çdo çështje që ERE e konsideron të nevojshme.

2. Nëse aplikuesi nuk paraqet informacionin shtesë brenda afatit, formës dhe përmbajtjes së caktuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s mund të refuzojë dhënien e licencës.

Neni 12

Kontrolli i saktësisë së të dhënave të paraqitura nga aplikuesi

1. Pas përfundimit të periudhës së marrjes së objeksioneve sipas nenit 10, pika 5 dhe 6, të kësaj rregullore, Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun do të analizojë të gjitha objeksionet e mundshme të dërguara nga palë të treta, dokumentet e depozituara (aplikimi) nga aplikuesi, si dhe çdo informacion shtesë të marrë me kërkesë të ERE-s, nëse përputhen me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Pas kontrollit të dokumentacionit, drejtoritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do t’i paraqesin Bordit një raport duke sugjeruar dhënien ose refuzimin e licencës, si dhe arsyetimet përkatëse në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Vendimmarrja e Bordit të Komisionerëve

1. Pas skadimit të afatit për paraqitjen e objeksioneve ose ankesave, Bordi i Komisionerëve të ERE-s shqyrton aplikimin në përputhje me kriteret e specifikuar në nenin 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Në marrjen e vendimit për dhënien ose refuzimin e një licence, Bordi i ERE-s merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:

a) kompletimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion shtesë të ERE-s;

b) vendndodhjen dhe territoret në të cilat do të kryhet veprimtaria e licencuar;

c) funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të impianteve të pajisjeve dhe/ose të rrjetit;

d) kërkesat për llojin e burimeve parësore të energjisë;

e) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, jetën e qytetarëve, pasurinë, shëndetin dhe rendin publik;

f) kërkesat financiare;

g) mbrojtjen e mjedisit;

h) nxitjen e efikasitetit të energjisë në sektorin e energjisë elektrike;

i) detyrimet e shërbimit publik siç parashikon ligji;

j) nxitjen e tregut kompetitiv të energjisë elektrike dhe parimet e kostos më të ulët në furnizimin me energji elektrike;

k) efektin ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Në marrjen e vendimit të tij, Bordi i ERE-s shqyrton:

a) aplikimin, si dhe çdo informacion shtesë të paraqitur nga aplikuesi;

b) çdo objeksion ose ankesë të paraqitur nga personat e interesuar;

c) raportin e hartuar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Neni 14

Dhënia ose refuzimi i licencës

1. Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për dhënien ose refuzimin e licencës brenda 90 ditëve nga data e publikimit të parë të njoftimit të aplikimit në shtyp, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Për centralet me fuqi të instaluar deri 5 MW, Bordi merr vendim jo më vonë se 45 ditë nga data e publikimit të parë të aplikimit në shtyp, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

3. Vendimi përfundimtar do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë arsyetimin për dhënien ose refuzimin e licencës.

4. Vendimi i ERE-s i dhënë sipas kësaj rregullore publikohet në Fletoren Zyrtare.

5. Vendimi i ERE-s lidhur me dhënien ose refuzimin e licencës mund të apelohej në gjykatë nga aplikuesi ose çdo person që ka një interes ligjor.

KAPITULLI III

MODIFIKIMI DHE RINOVIMI I LICENCËS

Neni 15

Procedurat për modifikimin e licencës

1. Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarit ose me iniciativën e vet, ERE mund të modifikojë termat dhe kushtet e një licence që konsideron të papërshtatshme, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 19 të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. ERE mund të vendosë modifikimin e licencës në rastet e mëposhtme:

a) kur ka ndryshime të rrethanave në datën e lëshimit të licencës (kuadri ligjor, vendime të gjykatës) ose të disa ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në prodhimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike ose tregun e energjisë elektrike;

b) kur këto ndryshime e bëjnë të pamundur plotësimin e pjesshëm ose të plotë të kushteve të vendosura në licencë;

c) kur ka ndryshime në strukturën e të licencuarit, duke përfshirë ndarjen, bashkimin ose transformimin në një person tjetër.

3. Nëse ERE vendos të ndryshojë një licencë, duhet t'i lëshojë të licencuarit një licencë me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar pjesët e ndryshuara të licencës së mëparshme.

Neni 16

Rinovimi

1. Jo më vonë se 3 muaj para përfundimit të licencës së dhënë, personi mund të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesë me shkrim dhe një informacion të detajuar ku të përshkruhet veprimtaria e kryer;

b) dokumentet mbi identifikimin e personit, dokumentet ligjore dhe financiare të caktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga paraqitja e kërkesës në ERE;

c) çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.

2. Kriteret për marrjen e vendimit nga Bordi janë të njëjta si në rastin e një licencimi.

3. Bordi mund të marrë në konsideratë në rastin e rinovimit të licencës edhe përmbushjen e kushteve të licencës në aktivitetin e licencuar nga aplikuesi.

4. Në rastin e rinovimit të licencave për veprimtaritë e importit ose eksportit të energjisë elektrike, ERE do të njoftojë menjëherë pas marrjes së kërkesës ministrin e linjës.

5. Bordi do të marrë vendimin për rinovim jo më vonë se 45 ditë nga paraqitja e kërkesës konform rregullave.

KAPITULLI IV REGJISTRI I LICENCAVE

Neni 17

Forma e regjistrimit

1. Licencat e lëshuara për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike do të mbahen nga ERE në regjistrin e licencave.

2. Regjistri i licencave mbahet me shkrim dhe në mënyrë elektronike. Me regjistrin mbahet edhe kartela shoqëruese e gjithë dokumenteve shoqëruese të një aplikimi.

3. Në regjistër futen detajet e mëposhtme:

- a) Numri i licencës;
- b) Data e miratimit të licencës;
- c) Data e lëshimit të licencës;
- d) Emri i të licencuarit;
- e) Vendndodhja e të licencuarit;
- f) Përshkrimi i aktivitetit, i cili është objekt i licencës së lëshuar;
- g) Kohëzgjatja e licencës;
- h) Skadimi i licencës;
- i) Data dhe përshkrimi i çdo modifikimi, ose heqje të licencës.

Neni 18

E drejta për t'u informuar mbi përmbajtjen e regjistrimit

1. Regjistri i licencave është i hapur për publikun. E drejta e inspektimit të regjistrimit jepet vetëm në ambientet e ERE-s.

2. E drejta e hyrjes në dosjen e dokumenteve shoqëruese u jepet personave me interes ligjor, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

3. Informacioni konfidencial ose i biznesit nuk do të jetë i disponueshëm për inspektim ose shqyrtim publik, përderisa publikimi i tyre mund të sjellë dëme ekonomike.

KAPITULLI V DISPOZITA TË TJERA

Neni 19

Transferimi

1. Në rastin e transferimit të aseteve, personi jo i licencuar, të cilit i janë transferuar asetet, do të aplikojë në ERE për një licencë të re. Kjo kërkesë do të trajtohet si në rastin e një kërkesë për rinovim licence.

2. Në rastin e transferimi të pjesshëm, ERE, para se të vendosë për licencimin e personit tek i cili janë transferuar asetet, do të kryejë me iniciativën e saj modifikimin e licencës së personit të licencuar që ka kryer transferimin e pjesshëm.

Neni 20

Periudha tranzitore

Të gjitha aplikimet për licencë të re apo për modifikim të licencës që janë paraqitur në ERE para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të trajtohen sipas dispozitave të rregullores së mëparshme.

KAPITULLI VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 22

Shfuqizime

Rregullorja e procedurave të licencimit dhe rregullorja për procedurat e licencimit për ndërtimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale, të miratuara përkatësisht me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr.37, datë 9.7.2004 dhe nr.44, datë 14.10.2004 shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

VENDIM

Nr.22, datë 11.4.2007

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA H/C "EGNATIA", KOMUNA HOTOLISHT, LIBRAZHD,
TE "REMI" SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa "A" dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 14.10.2004 "Rregullore për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale" neni 9, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Remi" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga H/C "Egnatia", komuna Hotolisht, Librazhd,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave lidhur me licencimin e "Remi" sh.p.k., për aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga H/C "Egnatia", komuna Hotolisht, Librazhd.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta**

VENDIM

Nr.23, datë 11.4.2007

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR
TRANSFERIM TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA
“DARDANIA ENERGI” SHPK TEK “EN-KU” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa “a”, dhe 20 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa “A”, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 14.10.2004 “Rregullore për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale” neni 9, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “En-Ku” sh.p.k., për transferimin e licencës nga shoqëria “Dardania Energji” sh.p.k., për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga H/C Bicaj, Kukës

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave lidhur me transferimin e licencës për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga H/C Bicaj, Kukës, nga “Dardania Energji” sh.p.k., tek “En-Ku” sh.p.k.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta**

**VENDIM
Nr.24, datë 11.4.2007**

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT UNIK TË
ENERGIJË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA ME FUQI TË
INSTALUAR DERI NË 10 MW, TË DHËNA ME KONCESION**

Në mbështetje të nenit 26, pika 1, dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, kreu IV, pika 1,a, të këtyre rregullave, dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.13, datë 5.3.2007 “Për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për metodën e përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, sipas tekstit bashkëlidhur.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta**

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË ÇMIMIT TË UNIFIKUAR PËR ENERGJINË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW

Autoriteti

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për energjinë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (me të gjitha ndryshimet) dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve.”.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është të përcaktojë një çmim unik për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, bazuar në rolin dhe përgjegjësitë e ERE-s për nxitjen e investimeve në burime të reja gjeneruese, me synim rritjen e transparencës, si dhe krijimin e kushteve të qëndrueshme, afatgjata, për pjesëmarrjen e sektorit privat në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

1. Termat e përdorur në metodologji

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

1.1 “Çmimi unik” - çmimi i njëjtë i energjisë elektrike, i përcaktuar nga ERE sipas kësaj metodologjie për HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion.

1.2 “Çmimi mesatar i importit” - çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., në vitin paraardhës, që rezulton si raport i vlerës totale të fondit të shpenzuar për import me sasinë totale të energjisë elektrike të importuar në të njëjtin vit.

1.3 “Koeficienti i barabartë me 1.1” - bonusi që u jepet të licencuarve për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për reduktimin e humbjeve në masën 10% të sasisë së injektuar prej tyre në sistem në rrjet, si pasojë e lidhjes së këtyre burimeve pranë ngarkesave në TM/TU.

2. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

2.1 Kjo metodologji është hartuar në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (me të gjitha ndryshimet), akteve të tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

2.2 Energjia elektrike e prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, injektohet direkt me rrjetin TM/TU në shpërndarje. Në rastet kur e kërkon koncesionari, KESH sh.a. (subjekti i furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë) detyrohet të blejë energjinë elektrike të prodhuar nga kjo kategori prodhuesish me kontratë afatgjatë, me qëllim rishitjeje të klientët tariforë që furnizohen në rrjetin e shpërndarjes.

2.3 Çmimi unik llogaritet duke iu referuar çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., në vitin paraardhës.

2.4 Çmimi unik, sipas kësaj metodologjie, do të rregullohet në funksion të ndryshimeve të çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike dhe normës mesatare të shkëmbimit euro/lekë të publikuar nga Banka e Shqipërisë për të njëjtin vit.

2.5 Çmimi unik llogaritet për të gjitha HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion sipas dispozitave të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe

vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”.

3. Formula e llogaritjes së çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion

3.1 Çmimi unik i energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, përcaktohet nga ERE në fillim të çdo viti.

3.2 Për të gjithë të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, që zgjedhin t’ia shesin energjinë elektrike të prodhuar prej tyre KESH sh.a.-së, çmimi unik llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$P_U = P_I * 1.1 * R_{EX}$$

ku:

P_U – çmimi unik i energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

P_I – çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike të realizuar nga KESH sh.a. në vitin paraardhës.

Koeficienti=1.1-bonusi që u jepet të licencuarve për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

R_{EX} – norma mesatare e shkëmbimit euro/lekë të publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin paraardhës.

4. Dispozita përfundimtare

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion sipas dispozitave të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave në zbatim të tij nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” u miratua nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike me vendimin nr.24, datë 11.4.2007.

VENDIM

Nr.25, datë 11.4.2007

PËR PËRCAKTIMIN, PËR VITIN 2007, TË ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA HEC-ET E REJA, ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW, TË DHËNA ME KONCESION

Në mbështetje të neneve 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, kreu IV, pika 1,a, vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr.14, datë 5.3.2007 “Për fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion për vitin 2007” dhe vendimit nr.24, datë 11.4.2007 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë me koncesion në bazë të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e reja, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhëna me koncesion për vitin 2007, është 6.5 lekë/kWh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preket nga rehabilitimi i rrugës së Zall-Herrit.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I REHABILITIMIT TË RRUGËS SË ZALL-HERRIT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.pas	Lloji pas.	Sip.	Çmimi	VI/lekë
1.	Kujtim	Ali	Shera	2066	218/1	truall	335	708.1	237213.5
2.	Qemal	Rexhep	Gurra	2066	162/27	arë	376	606	227 856
3.	Ndoc	Ndoc	Pepkolaj	2066	220/1	arë	445	606	269 670
	Total						1 156		734 739,5

Vlera totale e këtij shpronësimi është shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesë.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, e cila preket nga realizimi i projektit të furnizimit me ujë nga rezervuari i Manskurisë në Golem.

Subjekti kërkues i këtij objekti është ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve sh.a. Kavajë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që paraqitet në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I REALIZIMIT TË
PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË NGA REZERVUARI I MANSKURISË GOLEM

Nr.	Emri	ZK	Nr.pas	Sip.tokë bujqësore	Çmimi l/m ²	Vlera lekë	Vlera totale lekë
1.	Nazmi Riza Sinarez	2291	16/7	650	800	520 000	
	Shuma						520 000

Totali: 520 000 (pesëqind e njëzet mijë lekë).

KËRKESË

Shtetasja Admira Bezo, e bija e Rahmiut dhe e Bardhyles, e datëlindjes 10 mars 1952, lindur dhe banuese në Mbrostar Fier, kërkon shpalljen të zhdukur të babait të saj, Rahmi Como.

KËRKUESJA
Admira Bezo

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:
 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500
 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600
 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300
 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500

Hyri në shtyp më 19.4.2007
Doli nga shtypi më 21.4.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja
Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë